



REPUBLIKA E KOSOVES-REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

|  |                               |                               |                               |
|--|-------------------------------|-------------------------------|-------------------------------|
| Pranuar / Doretuar<br>Puniljeno/Prodato<br>Received/Delivery | 12 01 3                       | viti<br>god<br>year           |                               |
| Organ /Njësia<br>Organ /Jedinica<br>Org /Unit                | Nr Prot<br>Br Prot<br>Prot No | Shtojca<br>Prilog<br>Appendix | Sasia<br>Kolicina<br>Quantity |
| SKUMSHK  | 242/2023                      |                               | 115                           |



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.627/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës - Kolegji për shqyrtimin e ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani -Kryetar, Jeton Koca dhe Ardita Haxhnikaj Demi-Anëtarë, me Çlirim Zeka Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, duke u bazuar në Aktgjykimin A.nr.1827/2021 të datës 12.12.2022 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.135/2020 të datës 23.04.2020 të parashtruar nga ankuesi

kundër Vendimit të

Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave MEPTINIS KZKA me nr. protokollit 1665 i datës 06.04.2020 të Ministrisë së Ekonomisë, Punësimit Tregtisë, Industrisë Ndërmarrmarrësisë dhe Investimeve Strategjike, në çështjen juridike "Shkelje e të drejtës në pagë", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datën 12.01.2023, mori këtë:

V E N D I M

I. REFUZOHET si e pabazuar ankesa me numër A.nr.135/2020 e datës 23.04.2020 e parashtruar nga ankuesi

II. MBETET në fuqi Vendimi i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave MEPTINIS KZKA me nr. protokollit 1665 i datës 06.04.2020 të Ministrisë së Ekonomisë Punësimit Tregtisë Industrisë Ndërmarrësisë dhe Investimeve Strategjike.

A r s y e t i m

Ankuesi \_\_\_\_\_ i punësuar sipas shkresave të lëndës në pozitën "Zyrtar i Lart për Akreditimin e Trupave Certifikues" në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë, përmesë e-

mailit më datë 23.04.2020 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimin ankimor, duke goditur Vendimin e Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave MEPTINIS KZKA me nr. protokolli 1665 i datës 06.04.2020, si vendim të pa ligjshëm dhe të nxjerr në kundërshtim me të drejtën materiale.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 28.04.2020 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, ndërsa Këshilli më datë 29.04.2020, me numër protokolli 780/2020, ka pranuar përgjigje në ankesë nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, me shkresat e bashkangjitura.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nga muaji janar i vitit 2019 deri me datën 08.10.2020, ka qenë jo funksional dhe nuk ka vendosur për ankesën e ankuesit, ndërsa me datën 01.06.2020 nëpërmjet shkresës me numër protokolli 985/2020, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ka njoftuar ankuesin për arsyet e mos shqyrtimit të ankesës, duke udhëzuar se mund të filloj konfliktin administrativ në Gjykatën Kompetente.

Ankuesi, ka iniciuar konfliktin administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë Departamenti për Çështje Administrative. Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative me datë 25.06.2021 ka nxjerr Aktgjykimin me numër A.nr.1078/20, i njëjti në Këshill është pranuar me datë 08.07.2021 sipas të cilit ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit dhe ka anuluar njoftimin e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës të datës 01.06.2020, duke e detyruar Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës që brenda 30 ditësh të vendos për ankesën me numër A.nr.135/2020 të datës 23.04.2020.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 05.08.2021 nëpërmjet të shkresës me nr.protokolli 4092/2021 ka njoftuar ankuesin se nuk mund të vendos lidhur me ankesën A.Nr.627/2021 të datës 08.07.2021, për shkak se Këshilli nuk ka korum, dhe ka udhëzuar të njëjtin mbi të drejtën e inicimit të procedurës gjyqësore në pajtim me Ligjin për Konfliktin Administrativ.

Ankuesi, përsëri ka iniciuar konflikt administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë Departamenti për Çështje Administrative. Gjykata Themelore në Prishtinë Departamenti për Çështje Administrative me datën 29.11.2022 ka nxjerr Aktgjykimin me numër A.nr.1827/2021, i njëjti në Këshill është pranuar me datë 12.12.2022 sipas të cilit ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit dhe ka anuluar njoftimin e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës të datës 01.06.2020, duke e detyruar Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës që brenda 30 ditësh të vendos për ankesën e datës 23.04.2020.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokoll 783/2020 të datës 23.04.2020 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; E-mail nga J.A. për [ankesa.kpmschk@rks-gov.net](mailto:ankesa.kpmschk@rks-gov.net) i datës 23.04.2020; Aktgjykim me numër A.nr.1827/2021 i Gjykatës Themelore në Prishtinë Departamenti për Çështje Administrative i datës 29.11.2022 i njëjti në Këshill është pranuar me datë 12.12.2022; Fletëkthesë e datës 12.08.2021; Fletëkthesë e datës 10.08.2021; Njoftim me numër protokoll 4092/2021 i datës 05.08.2021; Njoftim me numër protokoll 4093/2021 i datës 05.08.2021; Aktgjykim me numër A.nr.1078/20 i Gjykatës Themelore në Prishtinë Departamenti për Çështje Administrative i datës 25.06.2021 i njëjti në Këshill është pranuar me datë 08.07.2021; Njoftim me numër protokoll 985/2020 i datës 01.06.2020; Fletëkthesë e datës 01.06.2020; E-mail nga B.B. për A.B. me numër protokoll 789/2020 i datës 29.04.2020; E-mail nga A.B. për A.D. i datës 28.04.2020; Kërkesë për pagesë sipas koeficientit e datës 23.01.2020; Ankesë për mos harmonizimin e pagës komfor ndryshim dhe plotësimit të aktit të emërimit me numër protokoll 280 e datës 06.03.2020; Vendim i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave KZKA me numër protokoll 1665 i datës 06.04.2020; Rekrutim i Brendshëm Ministria e Tregtisë dhe Industrisë me nr. reference MTI/9 i datës 23.03.2017; Njoftim për kandidatin e suksesshëm me numër protokoll 568 i datës 12.04.2017; Ndryshim dhe plotësimi i aktit të emërimit i J.A. i datës 15.05.2017; Përshkrimi i Detyrave të Punës i datës 17.03.2017; Akt Emërim i J.A. i datës 30.01.2012; Përshkrimi i Detyrave të Punës i datës 30.01.2012; Lista e pagave prej datës 01.01.2020 deri 31.01.2020; Kërkesë për shpallje konkursi me numër protokoll 268 i datës 23.02.2017; Kërkesë për autorizimin e publikimit të konkursit të brendshëm me numër protokoll 1755 i datës 08.05.2017; Përshkrimi i Detyrave të Punës i datës 07.03.2017; Kërkesë për fillimin e rekrutimit (punësimi) Form.MAP-SHCK-01 i datës 06.03.2017; Shkresë e SIMBNJ e datës 22.03.2017;

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, fillimisht ka trajtuar kompetencën lëndore dhe lejueshmërinë e ankesë, duke konstatuar se ekziston kushtet për trajtimin e ankesës së ankuesit dhe pas shqyrtimit të shkresave të lëndës konstatoj se ankesa e parashtruar nga ankuesi është e pabazuar, sepse:

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës pretendon që të ngritët koeficienti nga shtatë (7) në tetë (8), sipas Ndryshim dhe Plotësimit të Akt Emërimit të datës 15.05.2017 (në këtë plotësim dhe ndryshim të akt emërimit është shkruar një paragraf se në momentin e sigurimit të buxhetit do të fillohet të bëhet pagesa sipas koeficientit 8).

Kolegji, në bazë të shkresave të lëndës ka konstatuar se, me datë 23.03.2017 Ministria e Tregtisë dhe Industrisë ka shpallur konkurs Rekrutim i Brendshëm në Drejtorinë e Përgjithshme të Akreditimit të Kosovës për pozitën "Zyrtar i Lartë për Akreditimin e Trupave Certifikues" ku në këtë konkurs ka aplikuar edhe ankuesi. Me datë 12.04.2017 me numër protokoll 568 është shpallur Njoftimi për kandidatin e suksesshëm. Pas përfundimit të afatit të ankesave prej tridhjetë (30) ditëve konkretisht me datën 15.05.2017 i është bërë Ndryshim dhe Plotësimi i Akt Emërimit për pozitën " Zyrtar i Lartë për Akreditimin e Trupave Inspektues dhe Certifikues" në Drejtorinë e Përgjithshme të Akreditimit të Kosovës

në kuadër të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë. Ankuesi, duke par që nuk po fillon pagesa nga koeficienti 7 me koeficient 8 ashtu siç e ka pasur të përshkrume ne akt emërim me datë datë 23.01.2020 nëpërmjet shkresës me nr. protokoll 104 ka bërë kërkesë tek Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë lidhur me rregullimin e koeficientit nga 7 në 8. Ndërsa nga Sekretari, i Përgjithshëm i Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë nuk ka pranuar asnjë përgjigje lidhur me kërkesën e tij. Ankuesi me datë 06.03.2020 me numër protokoll 280 ka bërë ankesë për mos harmonizimin e pagës konform ndryshim plotësimit të aktit të emërimit në Komisionin e Ankesave në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë. Ndërsa Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave ka nxjerr Vendim me datë 06.04.2020 me numër protokoll 1665 me të cilin i ka refuzuar ankesën duke arsyetuar vendimin marrjen se ankuesi ka humbur afatin e paraqitjes së ankesës. si të papranueshme ankesën e ankuesit.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, lidhur me pretendimin ankimor të ankuesit për harmonizimin e koeficientit ka konstatuar se ankuesi prej momentit të Ndryshim dhe Plotësimit të Akt Emërimit të datës 15.05.2017 të cilën ankuesi e ka nënshkruar deri në ditën e parashtrimit i ankesës në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave kanë kaluar 33 muaji duke mos e marrën asnjë veprim ankuesi edhe pse ankuesi për 33 muaj është paguar me koeficientin 7 gjithashtu brenda kësaj periudhe janë aprovuar 3 bugjete të Republikës së Kosovës dhe ankuesi ka qenë në njohuri se nuk po i paguhet rroga sipas koeficientit 8.

Kolegji konstaton se ankuesi me paraqitjen e ankesës me datë 06.03.2020 ka vepruar në kundërshtim me Ligjin Nr.05/L031 për Procedurën Administrative me nenin 127 paragrafin 1 i cili përcakton se “: 1. *Ankesa duhet të parashtrohet brenda tridhjetë (30) ditëve nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ.* dhe nenin 8 paragrafin 2 të Rregullores Nr. 05/2011 për Procedurat e Zgjidhjes së Kontesteve dhe të Ankesave, ku është përcaktuar se: *“Ankesa duhet të paraqitet brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga momenti kur nëpunësi civil konsideron se i janë shkelur të drejtat e tij nga marrëdhënia e punës”.*


Kolegji për Shqyrtimin dhe vendosjen e Ankesave, duke ju referuar rrethanave dhe fakteve si me lartë ka konstatuar se Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Ministrisë së Ekonomisë Punësimit Tregtisë Industrisë Ndërmarrësisë dhe Investimeve Strategjike me Vendimin me numër 1665 të datës 06.04.2020 ka shqyrtuar drejtë ankesën e ankuesit të datës 06.03.2020 dhe ka vepruar në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi sepse ka vërtetuar drejtë gjendjen faktike dhe bazën juridike lidhur me çështjen e kontestuar.

Andaj pas analizimit dhe vlerësimit të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 dhe nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
LËNDA ME NUMËR A.NR.627/2021

Çlirim ZEKA

  
Procesmbajtës

  
Esref SHABANI

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

Ankuesit

Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Industrisë Ndërmarrësisë dhe Tregtisë;

Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Industrisë Ndërmarrësisë e Tregtisë dhe

Arkivit të KPMSHCËK-së